



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 16, datë 29 / 1 /2026

“PËR
MIRATIMIN DHE PËRDORIMIN E SIMBOLIT “KORÇA EUROPEAN CITY OF
SPORT” NË KUADËR TË MARRJES SË TITULLIT “KORÇA QYTETI EVROPIAN I
SPORTIT, 2026”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1; nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.7, shkonja c, nenit 54, shkronja “k” dhe “l”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar, vlerësimit të organizatës Aces Europe, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e simbolit “Korça European City of Sport,” sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi në kuadër të marrjes së titullit “Korça European City of Sport, 2026”.
2. Simboli “Korça European City of Sport,” përdoret në të gjithë dokumentet administrative të prodhuara nga Bashkia Korçë, institucionet e saj të varësisë, njësitë administrative/lagjet, ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare ku bashkia zotëron mbi 50 % të kapitalit, kuotave apo aksioneve dhe në të gjithë shkresat dhe materialet e prodhuara nga Këshilli Bashkiak.
3. Simboli përdoret edhe në posterat, ftesat, si dhe në të gjitha eventet e Bashkisë Korçë që do të zhvillohen në kuadër të “Korça European City of Sport, 2026”.
4. Simboli “Korça European City of Sport, 2026”, sipas këtij vendimi përdoret gjatë gjithë vitit 2026.

5. Ngarkohet Këshilli Bashkiak, Bashkia Korçë, institucionet e saj të varësisë, njësitë administrative, rajonet administrative, ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare ku bashkia zotëron mbi 50 % të kapitalit, kuotave apo aksioneve për zbatimin e këtij vendimi.
1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NACI



Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kundër 4

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-1-2026

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK



Model 1 (për dokumentet që dalin nga institucioni)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË
(EMËRTESA E STRUKTURËS)

Nr. _____ prot.

Korçë, më ____ . ____ . ____

Lënda: (Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit).

**EMËRTIMI I PLOTË NË RASËN DHANORE, ME GËRMA KAPITALE, I
INSTITUCIONIT TË CILIT I DËRGOHET**

(Emërtimi i vendit ku ka selinë institucioni të cilit i dërgohet)

Për dijëni: (në rastet kur janë institucione të tjera për dijëni dhe shënohet emërtesa dhe vendi ku ka selinë institucioni, njësoj si më sipër)

Në vijim / Në përgjigje suajës / tonës me Nr.____, datë ____ . ____ . ____

.....

Konceptoi: nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i konceptuesit

Pranoi: nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të parë (nëse ka).

Miratoi: nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjësit të strukturës së nivelit të dytë (nëse ka).

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo



KORÇA

QYTETI EVROPIAN

I SPORTIT 2026